

NIVELI MESATAR [B1].

Detyra me shkrim

Thonë se fëmijën më shumë se gjithçka e rrit dashuria prindërore. Nuk e pata atë përkëdhelje dhe ngrohtësinë prindërore aq të nevojshme për moshën fëmijërore. Unë këtë nuk e kam provuar në asnjë çast të vetëm... Por, kam provuar një tjetër ngrohtësi dhe dashuri; atë të shokëve të mi në klasën e parë, në shkollën fillore dhe të mësueses sime. Po. Më kujtohet emri i saj, Klorinda Mosi. Unë, ai djalë i imët me sy të trembur e fytyrë të zbehtë, munda sërish të bëhem i “gjallë”, e befas trokita në “portat” e kujtesës suaj. Në ato kujtime të fëmijërisë sime të hershme, në vitet e klasës së parë fillore, kur mësuesja ime e dashur më dhuronte miqësinë e pastër e të sinqertë që dinë ta dhurojnë vetëm nënat me zemër të madhe. Mësuesja jonë e klasës së parë, *me* shtatin e saj të imët dhe të brishtë, mbante brenda vetes një botë të madhe ndjenjash të ndryshme. Ishte së pari nënë, e pastaj mësuese. Kishte hyrë në botën e gjithsecilit prej nesh, dhe fliste me ne duke u bërë si ne. Ajo kurrë nuk ka qenë e qetë dhe asnjëherë indiferente, sepse qetësinë ia merrnim ne me ‘çapkëllëqet’ tona.

Këto kujtime janë pjesë e jetës sime edhe sot e kësaj dite që kam krijuar një familje të ngrohtë dhe të shëndetshme. Kam dy fëmijë të mrekullueshëm, të cilët gëzojnë një jetë krejt ndryshe nga ajo e fëmijërisë sime. Kam një bashkëshorte që e dua si jetën, sepse të njëjtën dashuri marr prej saj. Përsëri më krijojnë një lloj marrëdhënie të dyfishtë. Në këtë realitet unë jetoj midis dy dashurive, mes kujtimeve për shokët dhe shoqet e shkollës fillore, mësueses sime që më dhuroi dashurinë dhe ngrohtësinë prej nëne dhe familjes sime. Të dyja këto marrin dhe japin gjithmonë me njëra - tjetrën.

(Nga Ilir Çumani)

1. Lexoni tekstin e mësipërm dhe rrethoni alternativën e saktë.

Fëmijën e rrit më shumë se gjithçka:

- A. Plotësimi i çdo dëshire të tij?
- B. Dashuria prindërore?
- C. Çokollatat dhe ushqime të tjera të gatshme?
- D. Mungesa e gjumit?

Çfarë ka provuar autori:

- E. Ngrohtësinë prindërore?
- F. Kënaqësinë për fitimin e lojës
- G. Ngrohtësinë e shokëve dhe të mësueses së tij?
- H. Ndjenjën e zemërimit?

Ku trokiti autori:

- I. Në portat e kujtesës?
- J. Në derën e klasës?
- K. Në zyrën e drejtorit?
- L. Në asnjërën prej tyre?

Cili apo cilat pohime janë të vërteta?

- M. Autori nuk do të kujtojë asgjë nga e kaluara.
- N. Fëmijët e tij kanë një jetë të ndryshme nga e tija?
- O. Autori përjeton vetëm ngrohtësinë e familjes së krijuar.
- P. Familja e tij është e ngrohtë dhe e shëndetshme.

2. Në fjalitë e mëposhtme ka disa mbiemra të përshtatur jo si duhet. Korrigjojini ata.

Nuk do të shkruaj në përgjithësi sepse më duket sa një gjë i vështirë aq edhe i lehtë njëkohësisht. Do të shkruaj për mësuesen i dashur duke i dhuruar një grimcë të vogël lumturie në ditën e saj. Ajo është njeriu që më dha një shkëndijë që herën i parë që e pashë. Nuk doja të dilja nga klasa. Doja të shikoja vetëm sytë e saj të thellë. Ishte i qetë, i ëmbël dhe asnjëherë i mërziur në fytyrë. Doja të dëgjoja sesi fliste me endje për profesionin fisnik që mbarte. Ishte ajo që më mësoi shkronjat e para, numrat e parë, gjithçka që kishte të bënte me fjalën 'Shkollë'. Sot është dita e saj. Dita e mësuesve. Ajo meriton gjithçka të bukura e të vërtetëa.

3. Plotësoni fjalitë me grupet e fjalëve përkatëse në kuti.

të pafajshëm	ndonjë mjet	përdoruesit e saj	për udhëtim
ka disa rregulla		dy kahet e saj	ligje të rrepta

- Asnjëherë mos kapërce rrugën pa u siguruar se nuk ka mjet nga _____.
- Drejtimi i tij në rrugë _____ të caktuara dhe shumë të rrepta.
- Kurrë mos tejkalohet kufijtë e shpejtësisë që të rekomandon sinjalistika rrugore.
- Mos u nis _____ pa vendosur rripin e sigurimit.
- Rregullat e qarkullimit klasifikohen si _____.
- Rruga është një mënyrë komunikimi që ndihmon të gjithë _____ për rritjen e cilësisë së jetës.
- Thyerja e tyre nga padija, nënvleftësimi apo me dashje, ndëshkon shumë rëndë, jo vetëm ata që i thejnë, por edhe qytetarët e tjerë _____ që qarkullojnë.

Ku mungojnë këto, sigurohu se nuk po vjen _____ dhe pastaj kalo.

4. Ktheni përemrat pronorë në vetën e dytë.

Ishte një ditë e bukur shtatori. Fillimi i vitit të ri shkollor. E për mua, fillimi i një jete të re, asokohe me shumë të panjohura. Në oborrin e shkollës arrita së bashku me gjyshen time, e cila sa e sa herë më kishte folur për shkollën dhe mësuesin tim të parë. Dridhësia nga emocione të gërshetuara. Ia shtrëngoja dorën gjyshes. Ishte ky, mbase një moment mjaft i veçantë i jetës sime. Ëndrra ime tani po kthehej në realitet... Tek dera e shkollës qëndronte një mesoburrë, i cili buzëqeshte. Do të jetë ky mësuesi im i parë, me të cilin do t'i kaloja ditët e vitit të parë të shkollimit tim. Dhe ashtu ishte. Na përqafoi të gjithëve me radhë. Kurrë nuk do t'i harroj ata gishtërinj, të cilët lehtë-lehtë e ledhatuan fytyrën time që ishte e përshkuar nga të dridhurat. Më në fund, filloi edhe ora e parë e mësimit.

5. Duke përdorur foljet e mëposhtme, formoni fjali nxitëse ose dëshirore.

Lëre
Paçin
Të takohemi
Fol
Dëgjoni

6. Vini emrat në rasën e duhur:

Të gjithë (fëmijë) _____ janë kureshtarë dhe kanë dëshirë të mësojnë gjëra të reja. Foshnja ndjek (lëvizje) _____ e të rriturve dhe mëson nga ato, si lëvizjen (buzë) _____, (shikim) _____, (lëvizje) _____ e duarve. Fëmija duhet lënë të provojë gjërat e reja që i mëson. Kur foshnja rritet mëson edhe më tepër. Mund ta mësoni për shumë gjëra duke e shëtitur në (vend) _____ të ndryshme, duke i lexuar (libër) _____ etj. Të gjitha këto (mësim) _____ janë në dobi (fëmijë) _____ sidomos kur të fillojë shkolla. Për ta është me rëndësi loja ku mund të provojnë aftësinë krijuese. Loja e zhvillon fëmijën në (mënyrë) _____ të ndryshme. Përkujdesu që fëmija të ketë (lodër) _____ dhe (kohë) _____ për lojë.

7. Përshkruani mësuesin/mësuesen tuaj që ju ka lënë më shumë mbresa.